



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.12, datë 5.2.2007

**PËR  
MIRATIM DHËNIE BURSE SHTETI NXËNËSVE  
DHE STUDENTËVE TË VITEVE TË PARA, NË VITIN SHKOLLOR 2006-2007**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 11, pika 3/a, neni 12, pika 4, neni 32, gërma “n”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.737, datë 1.11.2006 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike” si dhe Planit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë për vitin shkollor 2006-2007 dhënie burse të plotë studentëve:
  - **Elira Qemal Gaçaj**, studente e vitit të parë pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, dega “Matematikë”.
  - **Arjol Tomorr Haxhillari**, student i vitit të parë pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, dega “Menaxhim-Turizëm”.
  - **Emirgena Ndrec Preçi**, studente e vitit të parë pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë, dega “Juridik”.

Raste të veçanta:

- **Tiziana Sasha Zgjoti**, studente e vitit të parë pranë Akademisë së Arteve, Fakulteti i Artit Figurativ, dega “Pikturë”.
  - **Marjola Luan Allamani**, studente e vitit të parë pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega “Mjedis”.
2. T’i kthehen bursat e pashfrytëzuara Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
  3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore (Sektori i Politikave Arsimore).
  4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**